



REPUBLIKA E SHQIPËRISË KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Tiranë, më 15.04.2019

RAPORT PËR PROJEKTLIGJIN

“PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, PËR NGRITJEN E PIKAVE TË PËRBASHKËTA TË KALIMIT KUFITAR, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE KRYERJEN E VEPRIMTARIVE TË PËRBASHKËTA TË KONTROLLIT KUFITAR”

Hyrje

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, mori në shqyrtim projektligjin “Për Ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kosovës, për ngritjen e pikave të përbashkëta të kalimit kufitar, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës dhe kryerjen e veprimtarive të përbashkëta të kontrollit kufitar”.

Në mbledhjet e Komisionit për të mbrojtur projektligjin dhe për të dhënë shpjegime për pyetjet e anëtarëve të Komisionit ishin të pranishëm përfaqësues të Ministrisë së Brëndshme.

I. BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga Këshilli i Ministrave, sipas përcaktimeve të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohet me relacionin përkatës, sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

Ratifikimi i kësaj marrëveshje bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kreu II “Marrëveshjet Ndërkombëtare”, neni 121 i saj.

II. QËLLIMI I PROJEKTLIGJIT DHE PËRMBAJTJA E TIJ

Qëllimi i këtij projektligji është thjeshtëzimin dhe lehtësimin e procedurave dhe të masave të lidhura me kontrollet kufitare të menaxhimit të qarkullimit ndërkufitar ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës. Marrëveshja parashikon që pikat aktuale jo të përbashkëta të kalimit kufitar të ndryshojnë statusin në pikat të përbashkëta të kalimit kufitar, ndërsa pikat e kalimit kufitar që

mund të hapen në të ardhmen do të rregullohen sipas parashikimeve të kësaj marrëveshjeje. Marrëveshja minimizon kohën e e përpunimit të të dhënave të shtetasve dhe mjeteve sepse kontrolli dhe verifikimi kufitar gjatë kalimit të kufirit kryhen të përbashkët.

III. PËRFUNDIM

Në aspektin ligjor, vlerësoj se projektligji i propozuar është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi.

Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Së fundi, si relator vlerësoj rëndësinë e miratimit të këtij projektligji dhe u kërkoj kolegëve ta miratojmë atë në Komision.

RELATORI

EDMOND LEKA

KRYETARI

ULSI MANJA